



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Ligjshmërisë

KA 33
K. Ankimore 33

Data 19.10.2023
Nr. Prot 7241

KËRKUES: KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

OBJEKTI: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

DREJTUAR: KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 25.4.2023, ka administruar 2 (dy) denoncime të ardhura nëpërmjet postës elektronike dhe nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 12227, datë 26.4.2023, të regjistruara me nr. 417 ID nga Z. Edmond Spaho, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara në bashkinë Maliq.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, nenet 91, 92, neni 171, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucioni publik nëpërmjet adresës së postës elektronike, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendimin si më poshtë vijon:

1- Në këto denoncime të regjistruara me nr. 417 ID pretendohet si vijon::

A. "Në kundërshtim me nenin 91, 92 të Kodit Zgjedhor, vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, në datë 24 Prill 2023, zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka postuar në faqen personale në rrjetin social Facebook, një takim me banorë të fshatit Plasë. Njësia Administrative Pojan, me qëllim promovimin e punëve të Bashkisë Maliq në këtë fshat, si:

1. Asfaltim i rrugës kryesore,
2. Rehabilitimin e terreneve sportive te shkollës.
3. Rehabilitim Ambulanca Plase.
4. Fillim i rehabilitimit i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit Plase.

Në takim kanë qenë të pranishëm drejtuesi politik i Qarkut Korçë z. Niko Peleshi, deputeti Ilir Pendavinji dhe Kryetarja e Këshillit të Qarkut Korçë znj. Ana Venushi.

Në takim janë bërë premtime elektrorale dhe ka pasur materiale propagandistike të Partisë Socialiste, të cilat dallohen qartësisht në fotot e publikuara. Kjo veprimtari, jo vetëm që është veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore por i behet sfidë e hapur organeve kompetente për monitorimin e fushatës si KQZ, zgjedhësve dhe subjekteve të tjera pjesëmarrëse në zgjedhje, duke cënuar parimin e barazisë dhe zgjedhjeve të lira me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e zgjedhjeve. Kërkojmë ndërhyrjen e menjëhershme të KQZ dhe në bazë të nenit 171/1 të Kodit Zgjedhor vendosjen e sanksionit administrativ"

B. "Zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka zhvilluar në datë 28.04.2023 aktivitete publike të ndaluara me vendim e sipërcituar.

Konkretisht, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e sipërcituar nr.413, datë 25.04.2023, ndalon zhvillimin e aktiviteteve publike të bashkisë Maliq, si më poshtë:

- Takim pune nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 14:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Takim pune nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 16:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Inspektim punimesh nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 11:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Inspektim punimesh nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan".

Në kundërshtim me këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kryetari i Bashkisë Maliq i ka zhvilluar këto takime dhe ka postuar në faqen personale në rrjetin social Facebook, foto të zhvillimit të këtyre aktiviteteve të ndaluar si më poshtë: (Foto e postimit ne facebook).

Për sa më sipër, denoncojmë kryerjen e këtyre aktiviteteve të cilat jo vetëm që janë veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, por i bëhet sfidë e hapur organeve kompetente për monitorimin e fushatës si KQZ, e cila dhe pse ka vendosur shënimin në ndërfaqen e raportimit "ndaluar nga KQZ", aktivitetet janë kryer."

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë

të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të denoncuesit më datë 13.5.2023, i është kërkuar informacion Bashkisë Maliq në lidhje me denoncimin e marrë dhe jemi informuar se: *“Referuar e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se Kryetari i Bashkisë është informuar dhe njohur me vendimin e KQZ për ndalimin e aktiviteteve të sipërcituara. Titullari nuk i ka kryer ato veprimtari publike, por ka vazhduar me takimet elektorale me banorë të njësive të ndryshme Administrative.”*

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023, nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 6.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. 417 ID, vlerësoj se nga verifikimi i provave dhe fakteve, rezultoi se për sa i përket denoncimit lidhur me takimin me banorë të fshatit Plasë (referuar në **pjesën A** të vendimit), vlerësohet se kemi të bëjmë me një takim elektorale të kandidatit në zgjedhje dhe jo një takim të organizuar nga bashkia Maliq, fakt ky i cili provohet nga materialet fotografike të postuara në profilin personal në rrjetin facebook, të kandidatit z. Gëzim Topçiu. Referuar në pretendimet e subjektit denoncues, vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ lidhur me këtë veprimtari objekt shqyrtimi pasi nuk kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar.

Për sa i përket denoncimit lidhur me takimet e zhvilluara me banorë në Njësinë Administrative Pojan (referuar në **pjesën B** të vendimit), bashkia Maliq ka zhvilluar aktivitetet e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar edhe pse titullari i këtij institucioni, z. Gëzim Topçiu ka patur informacion mbi ndalimin nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pohuar edhe nga vetë përgjigja e subjektit. Lidhur me natyrën e veprimtarisë së ndaluar vërehet se janë takime me banorë të një karakteri teknik dhe detyre funksionale, si dhe nuk evidentohet asnjë material zgjedhor i cili mund ta bënte këtë aktivitet, një aktivitet elektorale.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Maliq, për sa i përket **pjesës B** të këtij vendimi përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i bashkisë Maliq nuk duhej të zhvillonte veprimtari të cilat Komisioneri i kishte ndaluar. Edhe nëse do të zhvillonte veprimtari jo të karakterit publik, por te natyrës elektorale, atëherë zhvillimi i këtyre veprimtarive nuk duhet të përkonte me ato të cilat ishin ndaluar nga Komisioneri.



Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Maliq, për sa i përket **pjesës B** të këtij vendimi përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i bashkisë Maliq nuk duhej të zhvillonte veprimtari të cilat Komisioneri i kishte ndaluar. Edhe nëse do të zhvillonte veprimtari jo të karakterit publik, por të natyrës elektorale, atëherë zhvillimi i këtyre veprimtarive nuk duhet të përkonte me ato të cilat ishin ndaluar nga Komisioneri.

Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë nga 3 000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Kryetarit të bashkisë Maliq z. Gëzim Topçiu, gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimin nr. 795, datë 6.10.2023 “Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq, për zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluar”;
- Denoncimi nr. 417 ID, nga ndërfaqja e KQZ-së bashkëngjitur dhe fotografi;
- Raporti i monitorimit me Kod unik raporti: 19408590;
- Komunikimi nëpërmjet postës elektronike mbi çështjen, objekt shqyrtimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 795

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 417 ID TË Z. EDMOND SPAHO NDAJ Z. GËZIM TOPÇIU KRYETAR I BASHKISË MALIQ PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PUBLIKE TË NDALUAR NGA KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 6 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Z. Edmond Spaho, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

SUBJEKT: Z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq;

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq, për zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Bashkia Maliq ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 25.3.2023, veprimtaritë publike me objekt si më poshtë:

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 795
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq, për zhvillimin e veprimtarive publike të ndaluar"

1. *"Takim pune nr. 1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan"*, raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 14:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
2. *"Takim pune nr. 2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan"*, raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 16:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
3. *"Inspektim punimesh nr. 1 në Njësinë Administrative Pojan"*, raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 11:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
4. *"Inspektim punimesh nr. 2 në Njësinë Administrative Pojan"*, raportuar datë 24.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 28.4.2023 ora 12:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Pojan".
5. *"Kontroll punimesh në Njësinë Administrative Libonik"*, raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 16:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Libonik".
6. *"Takim pune me banorë të Njesisë Administrative Gore, Moglicë"*, raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 10:00, me vend të zhvillimit në "Njësia Administrative Moglice, Gore".
7. *"Inspektim punimesh në qytetin e Maliqit"*, raportuar datë 25.4.2023 për t'u zhvilluar në datë 29.4.2023 ora 15:00, me vend të zhvillimit në "Maliq".

Me vendimin nr. 413, datë 25.4.2023, në përputhje me përcaktimet e nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, është vendosur ndalimi i zhvillimit të veprimtarive publike, të planifikuara për tu zhvilluar sipas datave të raportimit nga institucioni.

Në vijim të procedurave administrative, nëpërmjet postës elektronike, po në datën 25.4.2023, është bërë njoftimi i bashkisë Maliq mbi vendimin nr. 413, datë 25.4.2023, për ndalimin e zhvillimit të aktiviteteve.

Më tej, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 25.4.2023, janë administruar 2 (dy) denoncime të ardhura nëpërmjet postës elektronike dhe nëpërmjet portalit të denoncimeve me nr. unik 12227, datë 26.4.2023, të regjistruara me nr. **417 ID**, për zhvillimin e veprimtarive të ndaluara në bashkinë Maliq.



Në këto denoncime të regjistruara me nr. **417 ID** pretendohet si vijon:

A. "Në kundërshtim me neni 91, 92 të Kodit Zgjedhor, vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator, në datë 24 Prill 2023, zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka postuar në faqen personale në rrjetin social Facebook, një takim me banorë të fshatit Plasë. Njësia Administrative Pojan, me qëllim promovimin e punëve të Bashkisë Maliq në këtë fshat, si:

1. Asfaltim i rrugës kryesore,
2. Rehabilitimin e terreneve sportive te shkollës.
3. Rehabilitim Ambulanca Plase.
4. Fillim i rehabilitimit i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit Plase.

Në takim kanë qenë të pranishëm drejtuesi politik i Qarkut Korçë z. Niko Peleshi, deputeti Ilir Pendavinji dhe Kryetarja e Këshillit të Qarkut Korçë znj. Ana Venushi.

Në takim janë bërë premtime elektrorale dhe ka pasur materiale propagandistike të Partisë Socialiste, të cilat dallohen qartësisht në fotot e publikuara. Kjo veprimtari, jo vetëm që është veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore por i behet sfidë e hapur organeve kompetente për monitorimin e fushatës si KQZ, zgjedhësve dhe subjekteve të tjera pjesëmarrëse në zgjedhje, duke cënuar parimin e barazisë dhe zgjedhjeve të lira me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e zgjedhje. Kërkojmë ndërhyrjen e menjëhershme të KQZ dhe në bazë të nenit 171/1 të Kodit Zgjedhor vendosjen e sanksionit administrativ"

B. "Zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka zhvilluar në datë 28.04.2023 aktivitete publike të ndaluara me vendim e sipërcituar.

Konkretisht, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e sipërcituar nr.413, datë 25.04.2023, ndalon zhvillimin e aktiviteteve publike të bashkisë Maliq, si më poshtë:

- Takim pune nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 14:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Takim pune nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 16:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Inspektim punimesh nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 11:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",
- Inspektim punimesh nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",

Në kundërshtim me këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kryetari i Bashkisë Maliq i ka zhvilluar këto takime dhe ka postuar në faqen personale në rrjetin social Facebook, foto të zhvillimit të këtyre aktiviteteve të ndaluar si më poshtë: (Foto e postimit ne facebook) Për sa më sipër, denoncojmë kryerjen e këtyre aktiviteteve të cilat jo vetëm që janë veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, por i bëhet sfidë e hapur organeve kompetente



për monitorimin e fushatës si KQZ, e cila dhe pse ka vendosur shënimin në ndërfaqen e raportimit "ndaluar nga KQZ", aktivitetet janë kryer."

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të denoncuesit më datë 13.5.2023, i është kërkuar informacion bashkisë Maliq në lidhje me denoncimin e marrë dhe jemi informuar se *"Referuar e-mailit tuaj ju bëjmë me dije se Kryetari i Bashkisë është informuar dhe njohur me vendimin e KQZ për ndalimin e aktiviteteve të sipërcituara. Titullari nuk i ka kryer ato veprimtari publike, por ka vazhduar me takimet elektorale me banorë të njësisve të ndryshme Administrative."*

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. nr. 691, datë 12.07.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 417 ID, 421 ID, 429 ID dhe 431 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 417 ID.

Pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023, nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përfundim të afatit për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për bashkëpunim.

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ, u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023, për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike nuk u paraqit asnjë prej palëve të njoftuara.

Në përfundim të hetimit administrativ për denoncimin me nr. 417 ID, vlerësoj se:

Nga verifikimi i provave dhe fakteve, rezultoi se për sa i përket denoncimit lidhur me takimin me banorë të fshatit Plasë (referuar në **pjesën A** të vendimit), vlerësohet se kemi të bëjmë me një takim elektorale të kandidatit në zgjedhje dhe jo një takim të organizuar nga bashkia Maliq, fakt ky i cili provohet nga materialet fotografike të postuara në profilin personal në rrjetin *facebook*, të kandidatit z. Gëzim Topçiu. Referuar në pretendimet e subjektit



denoncues, vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ lidhur me këtë veprimtari objekt shqyrtimi pasi nuk kemi të bëjmë me një veprimtari të ndaluar.

Për sa i përket denoncimit lidhur me takimet e zhvilluara me banorë në Njësine Administrative Pojan (referuar në pjesën B të vendimit), bashkia Maliq ka zhvilluar aktivitetet e ndaluar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas planifikimit të raportuar edhe pse titullari i këtij institucioni, z. Gëzim Topçiu ka patur informacion mbi ndalimin nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pohuar edhe nga vetë përgjigja e subjektit. Lidhur me natyrën e veprimtarisë së ndaluar vërehet se janë takime me banorë të një karakteri teknik dhe detyre funksionale, si dhe nuk evidentohet asnjë material zgjedhor i cili mund ta bënte këtë aktivitet një aktivitet elektorale.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Maliq, për sa i përket pjesës B të këtij vendimi përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i bashkisë Maliq nuk duhej të zhvillonte veprimtari të cilat Komisioneri i kishte ndaluar. Edhe nëse do të zhvillonte veprimtari jo të karakterit publik, por te natyrës elektorale, atëherë zhvillimi i këtyre veprimtarive nuk duhet të përkonte me ato të cilat ishin ndaluar nga Komisioneri.

Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T'i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative me gjobë në vlerën 3 000 (tremijë) lekë për:

Data: 06 Tetor 2023

Nr: 795

Ora: 12:00




"Për shqyrtimin administrativ ndaj z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq, për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar"

- Z. Gëzim Topçiu, kryetar i bashkisë Maliq.
- 2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
- 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Re: Kerkese per informacion, bashkia Maliq (417)

Ardita Gjini <arditagjini90@gmail.com>

Sun 5/14/2023 9:57 AM

To:denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Pershendetje,

Referuar emailit tuaj ju bejme me dije se Kryetari i Bashkise eshte informuar dhe njohur me vendimin e Kqz per ndalimin e aktiviteteteve te sipercituara. Titullari nuk i ka kryer ato veprimtari publike por ka vazhduar me takimet elektorale me banore te njesive te ndryshme Administrative.

Faleminderit.

On Sat, May 13, 2023, 1:28 PM denoncime <denoncime@kqz.gov.al> wrote:

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 11.5.2023, nëpërmjet postës elektronike, ka ardhur denoncimi nga deputeti z. Edmond Spaho, lidhur me zhvillimin e aktiviteteteve të ndaluara nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga bashkia Maliq, si më poshtë vijon:

"Zoti Gëzim Topçiu, kryetar në detyrë i Bashkisë Maliq ka zhvilluar në datë 28.04.2023 aktivitete publike të ndaluara me vendim e sipërcituar.

Konkretisht, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e sipërcituar nr.413, datë 25.04.2023, ndalon zhvillimin e aktiviteteteve publike të bashkisë Maliq, si më poshtë:

Takim pune nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 14:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",

Takim pune nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 16:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",

Inspektim punimesh nr.1 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 11:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",

Inspektim punimesh nr.2 me banorë të Njesisë Administrative Pojan, datë 28.04.2023, ora 12:00, vendi i zhvillimit të aktivitetit "Njësia Administrative Pojan",

Në kundërshtim me këtë vendim të KSHZ, kryetari i Bashkisë Maliq i ka zhvilluar këto takime dhe ka postuar në në faqen personale në rrjetin social Facebook, foto të zhvillimit të këtyre aktiviteteteve të ndaluara,si më poshtë: (Foto e postimit ne facebook)

Për sa më sipër, denoncujmë kryerjen e këtyre aktiviteteve të cilat jo vetëm që janë veprimtari në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore, por i bëhet sfidë e hapur organeve kompetente për monitorimin e fushatës si KQZ, e cila dhe pse ka vendosur shënimin në ndërfaqen e raportimit "ndaluar nga KQZ", aktivitetet janë kryer. "

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni nëse keni marrë dijeni për vendimin nr. 413, datë 25.04.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për ndalimin e zhvillimit të Veprimtarive me Karakter publik të Bashkisë Maliq"?

Nëse po, a i është përcjellë ky vendim për dijeni kryetarit të bashkisë Maliq?

Lutemi të na informoni brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishtikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Në nuk pranohet asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkakuar nga programe të dëmtshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

Njoftim per zgjatje afati (417, 421, 429 dhe 431 ID)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 7/13/2023 2:50 PM

Bcc:Partia Demokratike Dega Maliq <partidemokratikedegamaliq@gmail.com>;'AHC Office' <office@ahc.org.al>;Qendresa Qytetare <qendresacytetare@gmail.com>;Ylli Merkaaj <Ylli.Merkaaj@kqz.gov.al>;Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>;Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përshtëndetje,

Ju bëjmë me dije se, nëpërmjet vendimit nr. 691, datë 12 Korrik 2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve nr. 417, 421, 429 dhe 431 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023" Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka vendosur zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit tuaj.

Vendimin mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rubrikën "Akte të KQZ", "Akte të Komisionerit".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

